

Publikohet raporti për 2008-ën i Fondacionit "Heritage" dhe gazetës amerikane "Wall Street Journal"

Liria ekonomike, Shqipëria e 56-ta

Më problematike pronësia, vlerësim i njëjtë që nga 1988

TIRANE

Shqipëria është renditur e 56-ta në botë për sa i përket lirisë ekonomike.

Studimi i fundit nga Fondacioni "Heritage" dhe gazeta "Wall Street Journal", e rendit ekonominë si 63.3 për qind të lirë, duke lënë pas shumë vende të Ballkanit, përfshi edhe Bullgarinë apo Italinë. Në krahasim me një vit më parë, ekonomia shqiptare ka fituar 0.9 pikë. Në indeksin e 2008-ës janë përfshirë 162 vende. Sektorët e ekonomisë janë ndarë në 10 grupe. Nga këto, në 6 të tillë, Shqipëria ka arritur rezultate pozitive. Liria e biznesit dhe ajo e punës kanë pësuar rënie, ndërsa rritje të konsiderueshme të lirisë kanë pasur liria fiskale, pjesa e shpenzimeve qeveritare dhe liria e investimeve. Problem kronik i lirisë ekonomike të vendit ngelet ajo e pronësisë. Që nga viti 1998, Shqipëria arrin vetëm 30 pikë, nga 100 të mundshmet për sa i përket të drejtës së pronësisë. Ky është viti i 9-të radhazi që qeverisja nuk përmirëson një ndër pikat kryesore të lirisë ekonomike. "Totali i përgjithshëm i vlerësimit ulet nga zhvillimet e pakta të Shqipërisë në të drejtat e pronësisë dhe liria nga korrupsioni. Vlerësimi i dobët në të drejtat e pronësisë, kryesisht është rezultat i interferencës politike në gjyqësor, gjë që çon në zbatim të çrregullt të ligjeve". Raporti nënvizon gjithashtu se, liria ekonomike e Shqipërisë renditet mbi mesataren botërore dhe shifrat e saj janë rritur gjatë dy viteve të fundit, një arritje për t'u vlerësuar në një rajon të karakterizuar nga separatizmi federal dhe paqëndrueshmëria. "Nëse Shqipëria ruan lirinë e saj të fortë e impresionuese në investime, ndërsa lufton më shumë korrupsionin, vlerësimet e saj do të vazhdojnë të rriten". Ky është vlerësimi i fundit për lirinë ekonomike të vendit. Shqipëria ka fituar 7 vende në listën botërore, duke përmirësuar ndjeshëm imazhin e saj të ekonomisë së tregut. Sidoqoftë problemet e pronësisë dhe korrupsionit e bëjnë të vështirë hapjen e ekonomisë nga tregjet botërore. Në kapitullin e lirisë qeveritare theksohet se privatizimet janë akoma të vonuara dhe problematike. "Privatizimi dhe kompanitë e zotëruara nga shteti kanë qenë të parregullta dhe të ngadalta".

Dhjetë Sektorët e Ekonomisë

	2008	2007	
Liria e biznesit	63.3	64.1	▼
Liria e tregtisë	75.8	73.2	▲
Liria fiskale	90.3	87.3	▲
Pjesa e Qeverisë	76.0	75.1	▲
Liria monetare	80.4	80.3	▲
Liria e investimeve	70.0	60.0	▲
Liria financiare	70.0	70.0	▽
Të drejtat e pronës	30.0	30.0	▽
Korrupsioni	26.0	24.0	▲
Liria e punës	59.3	60.3	▼

Të dhëna

Liria e biznesit - 55.6%

Në Shqipëri regjistrimi i një biznesi të ri mund të kryhet brenda një dite të vetme, krahasuar me një mesatare në botë prej 43 ditësh. Por nga ana tjetër, të marrësh një licencë biznesi në Shqipëri duhet të plotësosh 24 procedura, krahasuar me një mesatare prej 19 procedurash në botë, dhe rreth 100 ditë më shumë krahasuar me mesataren në botë prej 234 ditësh. Por nuk mbaron me kaq. Rregulloret ndonjëherë janë kontradiktore dhe bizneset kanë vështirësi në sigurimin e kopjeve të ligjeve dhe rregulloreve.

Liria në tregti - 75.8%

Në Shqipëri nuk është dhe aq e lehtë të bësh tregti. Çdo mall që kalon traun e doganës shqiptare duhet të paguajë taksa. Me anë të taksave të importit synohet që vendosen çmime të drejta në treg pa dëmtuar produktet vendase. Por nga ana tjetër kompanitë që merren me importin e mallrave duhet të hasen dhe me një seri burokracish përpara se të zhdoganojnë mallin e tyre. Kjo e rrit edhe më shumë koston e të bërit tregti në Shqipëri. Për pasojë, Shqipërisë i ulet një 10 për qind pikë, nga pikët e lirisë në tregti.


Liria fiskale - 90.3%

Vitin e kaluar qeveria vendosi që tatimi mbi të ardhurat personale të jetë 10 për qind për të gjitha kategoritë e pagave. Pikërisht ky vendim i qeverisë duket se ka rritur stimulin për sipërmarrësit dhe punonjësit. Ndërkohë që këtë vit ka hyrë në fuqi pjesa tjetër e taksës së sheshtë. Nga 1 janari i këtij viti taksa e korporatës është 10 për qind. Përveç këtyre, ka edhe taksa të tjerë, që nuk janë ulur siç janë TVSH-ja, taksa mbi pronën dhe taksat që paguhen për automjetet. Vitet e fundit, të ardhurat totale të taksave si përqindje e GDP-së ishin 21.7 për qind.

Liria ndaj korrupsionit - 26%

Korrupsioni dominon në çdo sektor të ekonomisë shqiptare. Për rrjedhojë këtë vit vendi ynë renditet e 111-ta nga 163 vende në treguesin për transparencën e vlerësimit të korrupsionit ndërkombëtar. Krahasuar me një vit më parë, kjo tregon një lloj përmirësimi, por në raportet e Bankës Botërore shfaqen anketa të vazhdueshme të biznesit se korrupsioni është shumë i përhapur.

Krahasimi i lirisë ekonomike nga viti 1995



Albania Financial Sector Modernization



Job Location: Tirana

Target Starting Date: April 1, 2008

Bank of Albania and Association of Albanian Banks, with support from the World Bank's Convergence Program and the EU Interreg "Aquifalco" Program, are launching SPI ALBANIA, a public-private partnership to accelerate financial sector modernization. Under the auspices of a high-level public-private SPI Committee, a SPI Secretariat will prepare proposals for micro-regulatory reforms, designed by working groups where authorities and market participants collaborate closely in the perspective of EU Accession. SPI ALBANIA will be organized like a similar initiative in Romania (www.spi-romania.eu).

On behalf of SPI Albania, the Convergence Program wishes to hire the two members of the SPI Secretariat - a Director for Analytics and Policy and a Director of Bank Products and Services. Both will report to the Convergence SPI Albania Head.

I. Description of Core Responsibilities:

While the two Directors are expected to work as a team with a blurred division of roles, each of them will have a main professional focus as follows:

- " The Director for Analytics and Policy will prepare the proposals for SPI Committee consideration, building on work done by public-private working groups, in close cooperation with staff from relevant Albanian authorities and using international benchmarks wherever possible and consultants whenever needed.
- " The Director of Bank Products and Services will identify the regulatory improvements that may be necessary to allow Albanian banks and clients to interface in line with most advanced EU practices; will support the public-private working group discussions to reach practical results quickly; and will assist Albanian authorities in the prompt enactment of proposals endorsed by the SPI Committee.

II. Professional Requirements:

- Entrepreneurial desire to build a new "institution", under limited guidance, coping with ambiguity and uncertainties.
- Strong motivation to work hard under tight deadlines to meet ambitious objectives.
- Exceptionally developed interpersonal skills.
- Broad exposure to financial sector policy and business issues (min. 7-10 years).
- Proven business development and project management skills.
- Good analytical and quantitative skills.
- Excellent written and verbal communication skills, also in English.
- MBA or Masters in Finance/Economics/Law strongly preferred.
- Director for Analytics and Policy: public sector experience strongly preferred.
- Director of Bank Products and Services: banking or consulting experience strongly preferred.

III. Application: Interested candidates are invited to submit their CVs with a cover letter no later than January 31, 2008 at convergence@worldbank.org, indicating the position they are applying for. Please note that only short-listed candidates will be contacted.

IV. Conditions: Initial one-year contract. Competitive salary and benefits.